

RELACION TEKNIK

OBJEKTI:

" NDËRTIMI I UJËSJELLËSIT TË GRAMËS, DIBËR "



VITI 2020

6. Punimet e ndërtimit për realizimin e projektit

Punimet inxhinierike civile për këtë objekt përmbajnë komponentet baze të mëposhtem :

- Kaptazhin e burimeve pranë Liqenit të Gramës
- Grumbullimin e burimeve në një Basen Presioni të ndërtuar pranë liqenit
- Tubacionin me presion për percjelljen e prurjes nga Baseni i Presionit deri në Deponë e Qytetit Peshkopi

Secili nga elementet e mësipërme shërben për qëllime të veçanta :

- 1- Kaptazhet e burimeve mbledhin ujërat që dalin në burim. Me pas këto percillen drejt basenit të presionit. Një ndër funksionet e kaptazhit është edhe ruajtja e kushteve higjieno sanitare të ujit të pijshëm në mënyrë që të mos lejojë ndotjen, pasi uji do të perdoret si ujë i pijshëm.
- 2- Baseni i presionit është një veprë e cila do të ketë funksion akumulimin e prurjes së të gjithë kaptazheve, dhe do të projektohet i tillë që të mos lejojë rënien e nivelit të ujit në një vlerë të caktuar me qëllim mbajtjen nën ngarkesë të tubacionit të transmetimit, deri në deponë Peshkopi
- 3- Tubacioni i presionit, nënkupton të gjithë përberesit (objektet) që perdoren për të percjellë ujë në distancë relativisht të mëdha nga kaptazhi deri në depo. Tubacioni është një pjesë thelbësore e skemës së projektit dhe ka një kosto të konsiderueshme. Për rastin tonë rrjedha e ujit në tubacion është projektuar si rrjedhë me presion.

E dhënë në mënyrë skematike, varianti i propozuar për këtë ujësjes :